



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 21 qershor 2010
Nr. ref.: RK/26/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Lënda KI 25/09

Shefqet Haxhiu

kundër

Organizatës së punës "Industria e akumulatorëve"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Shefqet Haxhiu, me banim në Mitrovicë.

Pala kundërshtare

2. Palë kundërshtare është Organizata e punës "Industria e akumulatorëve" në Mitrovicë.

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

Çështja e lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që ta vlerësojë ligjshmërinë e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës të Organizatës së punës "Industria e akumulatorëve" në Mitrovicë.
4. Sipas parashtruesit të kërkesës, Rregullorja nuk është në pajtueshmëri me dispozitat pozitive ligjore, sepse nuk përmban përshkrimin e të gjitha detyrave të punës, që është bazë për vlerësimin e performancës dhe rezultateve të punës, gjersa pjesa tabelore e saj nuk respekton koeficientet dhe shkallët e matjes, në pajtim me kualifikimet arsimore.
5. Ai pohon se i është shkelur "e drejta e tij në vlerësim të barabartë të punësimit në lidhje me përcaktimin e pagesës".

Baza juridike

6. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Ligji), dhe Neni 54(b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

7. Më 20 maj 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese.
8. Më 29 prill 2010, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Snezhana Botusharova, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta refuzonte rastin si të papranueshëm.

Përmbledhje e fakteve

9. Nga parashtrimet e parashtruesit, shihet se atij i është ofruar punësimi nga Miniera e plumbit dhe zinkut, Korporata metalurgjike dhe kimike Trepça në Mitrovicë, më 1968. Më 16 shkurt 1988, Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës së Organizatës së punës "Industria e Akumulatorëve" (në tekstin e mëtejme - Rregullorja), është miratuar përmes një referendumi të mbajtur ndërmjet punonjësve.
10. Përmes letrës së 30 dhjetorit 1988, parashtruesi kërkoi nga Këshilli i punëtorëve të Organizatës së punës, emërimin e tij në një pozitë konform detyrave dhe kualifikimeve të tij, për arsye se ai i përmbushte të gjitha kriteret për sa i përket kualifikimit, përvojës së punës dhe kriterëve të tjera të përcaktuara, të domosdoshme për pozitën. Njëkohësisht, ai u ankua se Këshilli nuk e ka emëruar atë në një pozitë të tillë me vendimin e 1 janarit 1988, por kishte emëruar të tjerë të cilët nuk i kishin kualifikimet e duhura. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Këshilli për punësim, që ta emërojë atë në pozitën në fjalë dhe ta rinxjerrë një vendim të ri për këtë qëllim.

11. Më 1 prill 1993, Gjykata Kushtetuese në Beograd, shqyrtoi kërkesën e parashtruesit për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores së 16 shkurtit 1988, por e shpalli veten jokompetente për këtë rast.

Pohimet e Parashtruesit

12. Parashtruesi pohon se Rregullorja në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat pozitive ligjore, se nuk përmban përshkrimin e të gjitha detyrave të punës, se paraqet bazën për vlerësimin e performancës dhe rezultateve të punës, gjersa pjesa e saj tabelore, nuk i respekton koeficientet dhe shkallët e matjes, në pajtim me kualifikimet arsimore.
13. Parashtruesi ankohet se i është shkelur, “e drejta e tij në vlerësim të barabartë në punësim në lidhje me përcaktimin e pagesës”.

Vlerësimi për pranueshmërinë e kërkesës

14. Për ta gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj.
15. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vëren se ankesa e parashtruesit ka të bëjë me një periudhë që daton para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Blečić v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004) dhe, prandaj, përfundon se kërkesa është e parashkruar.
16. Nga kjo rezulton se parashtruesi, nuk i ka përmbushur kriteret formale për pranueshmëri të kërkesës, siç parashihet në Nenin 22.1 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 20 të Ligjit, dhe Nenin 54(b) të Rregullores së punës, njëzëri,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues

Dr. Iliriana Islami

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy